

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018	Kodi DA-IN-019
		Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022
		Faqe 1-7

Udhëzues për kalimin nga standardi SSH ISO 50001:2011 në
SSH ISO 50001:2018

Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit të energjisë

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese

Kontrolloi: Menaxheri i Cilësisë
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-019</p> <hr/> <p>Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022</p> <hr/> <p>Faqe 2-7</p>
---	--	---

1. QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga SSH ISO 50001:2011 në SSH ISO 50001:2018. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të energjisë të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të energjisë që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim. Ky dokument është i vlefshëm deri në datën 19 Shkurt 2022.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e organeve certifikuese që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit të energjisë në përputhje me këtë standard.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si i tillë është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Është detyrë e Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA

SSH ISO/IEC 17011:2017

Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit, Vendim i Asamblesë së Përgjithshme IAF 2017-14
Njoftimi i IAF COVID-19 FAQ Q20

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit SSH ISO/IEC 17011:2017

IAF Forum Ndërkombëtar i Akreditimit

DPA Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

6. PËRMBAJTJA

6.1. Të përgjithshme

Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit ka vendosur një periudhë tranzitore trevjeçare për kalimin nga standardi SSH ISO 50001:2011 në standardin SSH ISO 50001:2018. Referuar njoftimit të IAF COVID-19 FAQ Q20 periudha e tranzicionit për standardin SSH ISO 50001:2018 do të vazhdojë deri më datë 19 Shkurt 2022.

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018	Kodi DA-IN-019
		Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022
		Faqe 3-7

DPA do të kryejë vlerësime të tranzicionit për ISO 50001: 2018 nga data 19 shkurt 2019.

VEPRIMTARITË E CERTIFIKIMIT

6.2. Vlefshmëria e certifikatave të akredituara ISO 50001:2011

Për periudhën kalimtare, do të jenë të vlefshme si certifikatat e lëshuara sipas ISO 50001:2011, ashtu edhe ato të lëshuara sipas standardit të ri ISO 50001:2018.

Vetëm mbas datës së përfundimit të periudhës kalimtare (shih më sipër), certifikatat e akredituara të lëshuara sipas ISO 50001:2011 nuk do të jenë më të vlefshme.

Data e skadimit të certifikatave ISO 50001:2011 të lëshuara gjatë periudhës kalimtare duhet të përkojë me fundin e periudhës së tranzicionit.

Organet certifikues duhet të përfundojnë tranzicionin me DPA për ISO 50001: 2018 brenda dates 19 shkurt 2020. Gjithashtu Organe certifikues duke filluar që nga data 20 shkurt 2020 duhet të kryejnë aktivitetet e auditimeve, përfshirë auditimet fillestare, mbikëqyrjen dhe ricertifikimin sipas ISO 50001: 2018.

6.3 Rekomandime për Organet e certifikimit

Rekomandohet që Organet e Certifikimit të:

- a) Trajtojnë auditorët e tyre dhe të verifikojnë rezultatet me qëllim arritjen e një niveli të kënaqshëm kompetence.
- b) Informojnë klientët e tyre dhe t'i pajisin ata me një udhëzues për menaxhimin e tranzicionit.
- c) Planifikojnë afatet lidhur me auditimin dhe lëshimin e certifikatës për standardin e rishikuar.
- d) Të marrin parasysh si periudhën e vendosur për tranzicionin ashtu edhe periudhën aktuale të certifikimit.
- e) Planifikojnë në kohë auditet që do të kryhen te klientët aktualë.
- f) Planifikojnë në kohë afatet në lidhje me vendimet e certifikimit, për të përshtatur certifikatat në kohën e duhur.
- g) Nxisin klientët e certifikuar sipas versionit të mëparshëm të standardit që të vënë në zbatim versionin e ri.
- h) Nxisin organizatat që nuk janë të certifikuara që të zbatojnë që në fillim versionin e ri të standardit.

6.4 Zbatimi i kalimit të certifikimeve të akredituara nga ISO 50001:2011 në ISO 50001:2018

Certifikatat ISO 50001:2018 nën akreditim mund të lëshohen vetëm pasi organizata kliente ka dëshmuar përputhjen e sistemit të saj me ISO 50001:2018 te një Organ Certifikues i akredituar për lëshimin e certifikatave sipas standardit të ri.

Për të realizuar kalimin në standardin e ri, Organi Certifikues duhet të kryejë një audit te secili klient sipas ISO 50001: 2018.

Në bazë të marrëveshjes me organizatat e certifikuara, organi certifikues mund të kryejë veprimtaritë e

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018	Kodi DA-IN-019
		Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022
		Faqe 4-7

tranzicionit të standardit gjatë një auditi mbikëqyrës të planifikuar, gjatë një auditi të veçantë ose gjatë auditit për rinovimin e certifikimit. Kur auditimet e kalimit në standardin e ri kryhen së bashku me një audit të planifikuar të mbikëqyrjes ose rinovimit, Organi Certifikues do të vlerësojë nëse nevojitet kohë shtesë për të siguruar që të mbulohen të gjitha veprimtaritë si ato që lidhen me standardin ekzistues ashtu edhe ato me standardin e ri.

6.5 Certifikimet e organizatave sipas standardit në fjalë

6.5.1 Certifikimet e reja dhe ricertifikimet:

Certifikatat ISO 50001:2011 mund të lëshohen ose rinovohen sipas ISO 50001:2011 edhe gjatë periudhës së tranzicionit.

Data e skadimit të certifikimeve ISO 50001: 2011 të lëshuara ose rinovuara gjatë periudhës së kalimit duhet të përkojë me fundin e periudhës së tranzicionit.

6.5.2 Revokime:

Me përfundimin e periudhës së kalimit, mbas datës së përcaktuar më sipër, certifikatat e akredituara sipas ISO 50001: 2011 nuk do të jenë më të vlefshme, dhe duhet të revokohen.

6.6 Procesi i tranzicionit

Organi Certifikues duhet t'u komunikojë menjëherë klientëve dispozitat e tij në lidhje me kalimin në standardin e ri.

Organi certifikues duhet të zhvillojë një plan tranzicioni i cili përfshin pikat e mëposhtme:

- Trajnimin dhe verifikimin e kompetencës së auditorëve dhe të personelit tjetër të përfshirë.
- Komunikimet me klientët.
- Dispozitat e Organi Certifikues për të vlerësuar përputhshmërinë me standardin e ri. Për shembull, përmes një vizite të vetme të posaçme, ose në auditimet e planifikuara sipas ciklit të certifikimit.
- Veprimet që duhen ndërmarrë ndaj klientëve që nuk e kanë kryer tranzicionin brenda periudhës së kalimit. Për shembull, niveli i auditimit i nevojshëm për aktivizimin e certifikimit.

Gjithashtu, nevojitet që Organi Certifikues duhet të sigurojë që:

- a) të jenë identifikuar dhe theksuar qartë me atë të dokumentacionit përkatës të gjitha situatat për të cilat klientit i kërkohet të ndërmarrë veprime për të përmbushur kërkesat e reja.
- b) auditorët të këshillojnë certifikimin sipas ISO 50001:2018 vetëm atëherë kur të gjitha situatat e lëna pezull janë adresuar siç duhet dhe kur është dëshmuar efikasiteti i sistemit të menaxhimit të energjisë ndaj kërkesave të reja.
- c) nëse janë gjetur jokonformitete madhore në lidhje me kërkesat e standardit të ri, rekomandimi

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-019</p> <hr/> <p>Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022</p> <hr/> <p>Faqe 5-7</p>
---	--	---

për certifikimin sipas ISO 50001:2018 të bëhet vetëm pas mbylljes së veprimeve korigjuese dhe pas verifikimit të zbatimit dhe efikasitetit të tyre.

- d) vlerësimi i konformitetit të një klienti ndaj kërkesave të reja të standardit ISO 50001:2018, realizuar gjatë fazës së kalimit, nuk ndikon me konformitetin ndaj ISO 50001:2011.

Duke filluar nga data 2 Shtator 2019 deri me date 30 Shtator 2019 cdo organ certifikues duhet të dërgojë zyrtarisht në DPA planin e tranzicionit i cili duhet të raportojë përmbajtjet e paraqitura në shtojcën e këtij dokumenti, duke përfshirë edhe dokumentacionin shoqërues.

VEPRIMTARITË E AKREDITIMIT

6.7 Kërkesa të reja për Akreditim

Duke nisur nga data **1 qershor 2020**, DPA nuk pranon më asnjë kërkesë të re për akreditim ose zgjerim të fushës së akreditimit, që i referohet standardit të certifikimit ISO 50001:2011. Nese ka patur aplikime te reja ose per zgjerim sipas ISO 50001:2011 deri në datën 1 Qershor 2020 dhe vizita vlerësuese nuk është kryer deri në 30 Dhjetor 2020, atëherë vizita vlerësuese do të kryhet pas datës 1 Janar 2021 sipas S SH ISO 50001:2018.

6.8 Organet tashmë të akredituara sipas ISO 50001: 2011 - menaxhimi i tranzicionit

Organet Certifikuese përpara se të menaxhojnë praktikatat e certifikimit sipas standardit të ri, duhet të sigurohen që personeli i tyre i përfshirë direkt në këtë proces (stafi operativ, auditorët, anëtarët e komiteteve të vendimmarrjes së certifikimit), është trajnuar, ka nivelin e duhur të kompetencës, dhe njeh risitë e prezantuar nga standardi ISO 50001:2018 dhe ndikimet që rrjedhin prej tij.

DPA do të verifikojë përputhshmërinë e procesit të certifikimit me standardin e ri (vlerësim i kalimit në standardin e ri) me anë të një vlerësimi të dokumentacionit me një kohëzgjatje 1,0 ditë auditit kur ky vlerësimi bëhet off-site (jo në seli). Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e DPA do të llogaritet një ditë pune dhe do të paguhet nga organi certifikues i akredituar.

Në rast se rezultati i vlerësimit të dokumentacionit është negativ, mund të jetë e nevojshme kryerja e një vlerësimi të mëtejshëm, i cili, në varësi të llojit të gjetjeve, mund të përfshijë një vlerësim shtesë të dokumentacionit ose një vlerësim në zyrë ose një vlerësim me dëshmi ose një kombinim të tyre. Vizitat mbikëqyrëse shtesë do të zhvillohet brenda periudhës 10 Janar 2020 deri në 10 Shkurt 2020 Vizita mbikëqyrëse shtesë do të organizohet në përputhje me procedurën DA-PT-001. Për organet certifikuese të akredituara nga DPA që dështojnë në plotësimin e kërkesave të ISO 50001:2018, DPA do të reduktojë apo pezullojë fushën e akreditimit kundrejt këtij standardi.

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-019</p> <hr/> <p>Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022</p> <hr/> <p>Faqe 6-7</p>
---	--	---

Kur vlerësimi i dokumentacionit bëhet gjatë një vlerësimi mbikëqyrës ose riakreditimi, atëherë parashikohet një shtesë kohe 0,5 ditë auditi. Organi certifikues i akredituar ka të drejtë të kërkojë që mbikëqyrja shtesë të zhvillohet së bashku me mbikëqyrjen e rradhës nëse mbikëqyrja e rradhës është planifikuar brenda periudhës 10 Janar 2020 deri në 10 Shkurt 2020.

Grupi vlerësues i DPA-së do të verifikojë planin e tranzicionit, i cili duhet të raportojë përmbajtjet e paraqitura në shtojcën e këtij dokumenti, duke përfshirë planifikimin e kurseve të trajnimit për standardin e ri për të gjithë personelin e interesuar, dhe përshtatjen e listave të kontrollit/udhëzuesve të miratuar nga Organi Certifikues për menaxhimin e auditimit.

Është përgjegjësi e organeve certifikuese njohja me kërkesat e standardit S SH ISO 50001:2018 dhe hartimi i planeve të tranzicionit të certifikimeve të kryera prej tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e planeve të tranzicionit të certifikimeve.

Për të lehtësuar këtë proces tranzicioni, së bashku me këtë qarkore gjendet i bashkëngjitur një shembull për mënyrën e strukturimit të një Plani Tranzicioni. Ky plan duhet të vihet në dispozicion të Vlerësuesit / Grupit Vlerësues nga DPA për auditimin e kalimit në standardin e ri, së bashku me shtojcat përkatëse. Plani i Tranzicionit do t'i bashkëlidhet Raportit nga Vlerësuesit e DPA.

Në pritje të rezultatit të vlerësimit (i cili në rast të një rezultati pozitiv do të pasohet me lëshimin e certifikatës së re të akreditimit), Organet Certifikuese nuk do të jenë në gjendje të lëshojnë certifikata të akredituara sipas ISO 50001:2018.

Çdo jokonformitet i gjetur gjatë vlerësimit të tranzicionit që lidhet me procesin e akreditimit të Organit Certifikues, duke iu referuar standardit të ri, duhet të menaxhohet nga OVK përmes veprimeve korrigjuese, të cilat duhet t'i dërgohen DPA-së. Gjithashtu, duhet të vihen në dispozicion raportimet që vërtetojnë që të gjitha jokonformitetet e gjetura nga DPA në lidhje me standardin e ri, janë mbyllur përmes zbatimit të veprimeve korrigjuese (verifikim i zbatimit dhe efikasitetit) përpara se DPA të marrë vendim në lidhje me akreditimin sipas ISO 50001:2018.

Mbas datës së përfundimit të periudhës së tranzicionit, akreditimet e mbetura lidhur me certifikimin e sistemeve të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001:2011 do të revokohen.

Shtojcë 1: Shembull i planit të tranzicionit nga ISO 50001:2011 në ISO 50001:2018

Çdo OVK që dëshiron të përdorë këtë formular duhet ta plotësojë dhe ta vërë në dispozicion të grupit auditues të DPA-së për vlerësimin e tranzicionit në standardin e ri. Gjithashtu mund të bashkëngjisni dokumenta të tjerë, të cilët vlerësohen si të nevojshme për një vlerësim të saktë

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 5001:2018	Kodi DA-IN-019
		Rishikim nr 2 Dt 21.02.2022
		Faqe 7-7

Nr°	Pyetje	Hapësirë e rezervuar për DPA
1.	Si do të menaxhohet komunikimi me klientët në lidhje me menaxhimin e tranzicionit? Bashkëngjijt evidenca.	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
2.	Si dhe kur do të kryhet dhe vlerësohet trajnimi për personelin e përfshirë në veprimtaritë për certifikimin sipas standardit të ri?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
3.	Cilat dokumente të Organit Certifikues do të duhet të ndryshohen, dhe sa kohë do të duhet për shpërndarjen dhe zbatimin e tyre?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
4.	Si do të nxiten organizatat tashmë të certifikuar me versionin e mëparshëm të standardit për të zbatuar versionin e ri që në fazat e para?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
5.	A është parashikuar një kohë shtesë për veprimtaritë e kalimit të standardit në rast se kjo përkon me një audit mbikëqyrjeje ose ricertifikimi?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
6.	A keni identifikuar veprimet që duhen ndërmarrë ndaj klientëve që nuk kanë kryer tranzicionin brenda afatit? Për shembull, niveli i auditimit të nevojshëm për të aktivizuar certifikimin?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
7.	Planifikoni të bëni tranzicionin përmes një vizite të vetme të posaçme ose përmes disa fazave? (p.sh. kontroll të dokumentacionit, analizën e hendekut, verifikimin e disa kërkesave të reja çdo vit ...)? Si siguroheni që gjatë procesit të tranzicionit sistemet e klientit vazhdojnë të jenë në përputhje me versionin e mëparshëm të standardit?	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		
8.	Komente të tjera që dëshironi të shtoni për të shpjeguar më mirë se si do ta menaxhoni këtë tranzicion. Kujtojmë që, sipas nevojës, duhet t'i bashkëlidhni këtij plani prova dhe dokumentacion në mbështetje të përgjigjeve tuaja.	Mbyllur? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Teksti nga OVK.		